



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:160994

Datë: 25.02.2021

Numri i dokumentit: 01542842

AC.nr.4982/19

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Gëzim Llulluni kryetar, Nora Bllaca-Dula dhe Halide Reka anëtarë, në çështjen juridike të paditësit B.M nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson i autorizuari B.K, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim V.R nga Prishtina, për kompensimin e dëmit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.781/18 të datës 30.07.2019, në seancën e kolegjit e mbajtur me dt.15.02.2021 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.781/18 i datës 30.07.2019 në pikën I.a) dhe I.b) të dispozitivit dhe gjykohet si vijon: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, që paditësit B.M nga Prizreni, për dëmin material t’i paguaj dhe ate: për shpenzimet e mjekimit shumë prej 569.40€, për përkujdesje të huaj shumë prej 450.00€, ndërsa pjesa tjetër mbi shumë e gjykuar për këto kategori të dëmit, si dhe kërkesa e paditësit, që ka të bëjë me dëmin për dhimbje psikike, si dhe kërkesa që ka të bëjë për dëmtimin e sendeve, që përdoren për nevoja personale, rrobat etj.. refuzohen në tërësi si të pabazuara.

II.REFUZOHET pjesërisht e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “K...” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.781/18 i datës 30.07.2019, përveç ndryshimeve të mësipërme, në pjesët tjera, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I të dispozitivit, aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.M nga Prizreni, ashtu që detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë që në emër të kompensimit të dëmit ti paguaj si në vijim:

a) Dëmi jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore) duke përfshirë të gjitha format e saj në shumën prej...3,000.00€
- Për dhimbje psikike në shumën prej.....3,000.00€
- Për frikë për të gjitha format e saj shumën prej.....1,000.00€
- Në emër të zvogëlimit të aftësisë së përgjithshme jetësore prej 5%.....2,000.00€

b) Dëmi material:

- Për shpenzimet e mjekimit shumën prej.....1,000.00€
- Për përkujdesje të huaj.....700.00€
- Për ushqim të përforcuar.....500.00€
- Për fitim të munguar për shkak të paaftësisë së përkohshme për punë.....850.00€
- Për dëmtimin e sendeve që përdoren për nevojat personale, rrobat etj.....200.00€

Shumën e përgjithshme të cilën e paditura Kompania e Sigurimeve “K...”, me seli në Prishtinë detyrohet që t’ia paguaj paditësit B.M në emër të kompensimit të dëmit i cili rrjedh nga aksidenti i dt.16.11.2016, është 12,250.00€ (dymbëdhjetëmijë e dyqind e pesëdhjetë euro) të gjitha këto me kamatë ligjore në lartësi prej 8% duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afat prej 15 ditësh pas ditës së plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit me dhunë. Në pikën II të dispozitivit, kërkesëpadia e paditësit B.M, përtej shumave të aprovuara refuzohet si e pabazuar. Me të njëjtin aktgjykim në pikën III të dispozitivit, me shpenzimet procedurale obligohet e paditura e cila detyrohet që paditësit në emër të shpenzimeve procedurale t’i paguaj shumën 964.00 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura brenda afatit ligjor ka paraqit ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar dhe lënda i kthehet në rivendosje dhe rigjykim, gjykatës së shkallës së parë, ose të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të gjykohet në shumën e ofruar nga e paditura.

Përgjigje në ankesë, brenda afatit ligjor ka paraqitur i autorizuari i paditësit, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pabazuar dhe ta vërtetoj vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoj shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore ato të përgjigjes në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim me dispozitat e nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e të paditurës, është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: paditësi ka parashtruar padinë në gjykatën e shkallës së parë, e të cilën e ka precizuar me parashtrësën e dt.30.07.2019, duke kërkuar kompensimin e dëmit jo material dhe material nga e paditura, për lëndimet të cilat i ka pësuar në aksidentin e komunikacionit të dt.16.11.2016, të cilin e ka shkaktuar i siguruari i të paditurës. Si pasojë e këtij aksidenti, paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, kështu që për të gjitha format e dëmit kërkon kompensimin si në kërkesëpadi. Ndërkaq, i autorizuari i paditësit, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadija e paditësit të aprovet si e bazuar, sepse baza juridike e kërkesëpadiës është vërtetuar, ku e paditura pasi që ka dhënë ofertën për dëmin konsiderohet se, nuk e ka kontestuar bazën. Ndërkaq, natyra dhe llojet e dëmeve të cilat i ka pësuar paditësi, janë vërtetuar me ekspertizën mjekësore. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit dhe vlerësimit të provave, ka përfunduar me marrjen e aktgjykimit në të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë thekson se, në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza e kërkesëpadiës, ndërsa palës paditëse i është ofruar ofertë nga e paditura për arritjen e marrëveshjes. Kështu që, kontestuese ka ngelur lartësia e kërkesëpadiës, ku gjykata e shkallës së parë këtë e ka vërtetuar me ekspertizë mjekësore, ku ekspertet ortoped-traumatolog dhe psikiatër, duke u bazuar në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditësit, kanë dhënë mendimin profesional të tyre në ekspertizën e dt.01.02.2019, përkatësisht dt.10.09.2018. Sipas eksperteve, paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, të cilat i kanë përshkruar me detaje në ekspertizat e tyre. Sipas eksperteve, paditësi ka përjetuar dhimbje fizike nga ky aksident, ku e kanë cekur intensitetin dhe kohëzgjatjen e tyre. Përpos kësaj, sipas eksperteve tek paditësi zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor, është i shprehur në shkallën 5%, ku detajet lidhur me këtë i kanë cekur në ekspertizë, ndërsa gjykata në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar. Sipas eksperteve, ndihma e personit tjetër, ka qenë e nevojshme një muaj e gjysmë mbas aksidentit. Pastaj, ushqimi i përforcuar për paditësin sipas eksperteve ka qenë i nevojshëm prej dy muajve, po ashtu, paditësi ka pasur edhe shpenzime të mjekimit në mungesë të barnave në spitalet tona, ku i njëjti është detyruar që këto ti kryej nga buxheti personal. Eksperti-psikiatër i caktuar në këtë lëndë nga gjykata, ka vlerësuar se, paditësi ka pasur frikë primare dhe sekondare, për të cilat e ka bërë përshkrimin për të gjitha llojet e intensiteteve dhe kohëzgjatjen e tyre.

Gjykata e shkallës së parë, bazuar në konstatimet mjekësore lidhur me natyrën e lëndimeve të paditësit, e ka caktuar edhe lartësinë e dëmit për të gjitha format e dëmit material dhe jo material, për të cilat e ka detyruar të paditurën që ta bëjë një kompensim të tillë, ndërsa pjesën tjetër mbi shumat e aprovuara gjykata i ka refuzuar si të bazuar.

Këtë gjendje faktike të çështjes, gjykata e shkallës së parë e ka bazuar në dispozitat e nenit 183 par.1, 159, 136, 169, 174, 179 dhe 382 të LMD-së, si dhe nenit 323, 452 par.3 dhe 143 të LPK-së dhe ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, sa i përket pjesëve të vërtetuara me këtë aktgjykim, pasi që aktgjykimi i atakuar në ato pjesë, nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Pra, nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurës, shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga nenit 182 par.2 pika n) të LPK-së, sepse aktgjykimi i atakuar është i qartë dhe në harmoni të plotë me arsyetimin e dhënë, e në të cilin arsyetim janë dhënë arsye konkrete për faktet me rëndësi vendimtare, të cilat kanë ndikuar në marrjen e një aktgjykimi të tillë.

Gjithashtu, nuk qëndron pretendimi ankimor, për konstatim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, sepse gjykata e shkallës së parë duke e pasur në dispozicion prova të mjaftueshme të ofruara nga palët ndërgjyqëse, si dhe ekspertizat përkatëse mjekësore, ka vërtetuar natyrën e lëndimeve të paditësit në aksidentin e sipër cekur të komunikacionit, të cilat lëndime ekspertet mjekësor i kanë kualifikuar lëndime të rënda tek paditësi. Kështu që, gjykata e shkallës së parë duke pasur parasysh natyrën e lëndimeve të shkaktuara tek paditësi, për të gjitha kategoritë e dëmit material dhe jo material, ka caktuar shumën e përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, e për të cilat kjo gjykatë, i vlerëson si reale, e të cilat janë vërtetuar me këtë aktgjykim.

Ndërkaq, Gjykata e Apelit duke ekzaminuar aktgjykimin e atakuar, në pajtim me pretendimet ankimore të paditurës, vërejtje se, gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të formave të dëmit për disa kategori të dëmit material, që kanë të bëjnë me shpenzimet e mjekimit, përkujdesjen e huaj dhe dëmtimin e sendeve, ka caktuar shumën më të larta se sa ato të cilat zakonisht caktohen nga gjykatat në Kosovë, bazuar në kritere dhe në praktiken e mirë gjyqësore, lidhur me çështje të tilla, si kjo e paditësit, përkatësisht ka caktuar shumën e dëmit pa prova mbështetëse, (siç është me dëmtimin e sendeve”. Prandaj, duke konsideruar se gjykata e shkallës së parë ka bërë zbatim të gabuar të së drejtës materiale, sa i përket kategorisë së dëmit jo material që ka të bëjë me dhimbje psikike, ku ka caktuar shumën prej 3,000€, e cila kategori nuk parashihet si kategori e veçantë e dëmit me dispozitat ligjore të nenit 183 të LMD-së, e i cili ligj ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur aksidenti ndaj paditësit me dt.16.11.2016, kështu që, këtë formë të dëmit të cilën gabimisht e ka caktuar gjykata e shkallës së parë, së bashku me dëmin material, që ka të bëjë me dëmtimin e sendeve që përdoren për nevoja personale, kjo gjykatë i refuzoj në tërësi si të pabazuara në mungesë të provave, përkatësisht, mbështetjes ligjore.

Gjithashtu, Gjykata e Apelit vlerësoj se, bazuar në faturat të cilat i ka përshkruar edhe i autorizuari i paditësit në parashtrësën e tij, rezulton se, shpenzimet e shërimit janë në shumë 569.40€, pastaj nevoja për përkujdesje të huaj për paditësin ka qenë një muaj e gjysmë, përkatësisht 45 ditë, kështu që në emër të kësaj forme të dëmit gjykata i caktoj shumën 450.00€, ndërsa pjesën tjetër mbi shumën e gjykuara e refuzoj në tërësi si të pa bazuar, duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Sipas Gjykatës së Apelit, pretendimi ankimor, i të paditurës për fitimin e munguar, duke e konsideruar ekspertizën si jo profesionale, është i pa bazuar edhe i pa qëndrueshëm, sepse e paditura nëse ka menduar si tani, është dashur që një ekspertizë të tillë ta kundërshtoj, përkatësisht, të propozoj ekspertizë të re, çka në rastin konkret nuk e ka bërë, kështu që edhe gjykata e shkallës së dytë këtë kategori të dëmit e pranoj si reale, duke i besuar ekspertizës, e cila është bërë lidhur me këtë çështje.

Ndërkaq, sa i përket dëmit jo material, që ka të bëjë me dhimbje fizike, frikën e përjetuar dhe zvogëlimin e aftësisë së përgjithshme jetësore, si dhe dëmin material që ka të bëjë me ushqimin e përforcuar dhe fitimin e munguar, përfshirë këtu edhe shpenzimet procedurale, gjykata e shkallës së dytë, i vërtetoi duke i vlerësuar si shuma të caktuara në kuadër të kufijve, të cilët caktohen sipas kriterëve dhe praktikës së mirë gjyqësore në Kosovë të kohëve të fundit dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Gjykata e Apelit, për pjesën e vërtetuar dhe të ndryshuar me këtë aktgjykim, vlerëson se, shumat për të gjitha kategoritë e dëmit janë reale dhe në pajtim me praktikën gjyqësore që aplikohet kohëve të fundit në gjykatat e Kosovës, e i cili kompensim mund të shërbejë vetëm si satisfakcion për zvogëlimin sa do pak të dhimbjeve të përjetuara nga paditësi, në këtë aksident të komunikacionit të rastit konkret e asgjë më tepër.

Me dispozitën e nenit 183 paragrafi 1 të LMD-së, parashihet se *për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetësor, të shëmtimit, të vdekjes së personit të afërm...do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.*

Me të njëjtin nen në paragrafin 2, parashihet se, *me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të së mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim por edhe për atë , se me te mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën dhe me qëllimin shoqëror.* Në situatën konkrete të paditësit, u morën parasysh të gjitha këto dispozita ligjore me rastin gjykimin në këtë çështje juridike kontestimore.

Me sa u tha më lartë, e meqë gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plotë, e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë, në pjesët e vërtetuara me këtë aktgjykim, por gabimisht është zbatuar e drejta materiale në pjesët të cilat u ndryshuan me këtë aktgjykim, atëherë, në bazë të nenit 195 par.1 pika d) lidhur me pikën e) të LPK-së, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, NË PRISHTINË
AC.nr.4982/19 me dt.15.02.2021

Kryetari i kolegjit-Gjykatësi
Gëzim Llulluni